



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 1616 Prot.

Tiranë, më 25.04.2024

Lënda: Kërkesë për informacion

Drejtuar: Z. Altin DUMANI

Drejtues i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

I nderuar z. Drejtues i Prokurorisë,

Me ligjin nr. 33/2024 "Për dhënie amnistie", Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar rregullat për përfitimin e amnistisë nga persona të dënuar apo në procedim penal. Në një përgjigje për median, Prokuroria e Posaçme ka sqaruar se: "Nga analiza e Prokurorisë së Posaçme, për ndikimin e ligjit të sapo miratuar nr. 33/2024, "Për Dhënie Amnistie", ka një numër të dënuarish për veprën penale "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuar nga neni 245/1, i Kodit Penal, që përjashtohen nga vuajtja e dënimit. Për disa persona pavarësisht përfitimit të këtij ligji, e kanë vuajtur pjesën e dënimit të tyre. Nga ana tjetër nuk ka subjekte apo procedime që përfitojnë amnisti nga ndjekja penale. Mbështetur në të dhënat e Sektorit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Prokurorinë e Posaçme, ju informojmë se nga ky ligj përfitojnë një numër personash të dënuar, si më poshtë vijon: Për vitin 2021 janë 16 persona; Për vitin 2022 janë 24 persona; Për vitin 2023 janë 18 persona; Për vitin 2024 janë 22 persona".

Në këto kushte, në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999, "Statusi i deputetit", i ndryshuar, nenin 94 të Rregullores së Kuvendit, si dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, kërkojmë nga ana juaj të na informoni përsa më poshtë:

1. Përfituesit që përmenden në statistikat tuaja janë persona të dënuar për veprën penale "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuar nga neni 245/1, i Kodit Penal, dhe është kjo kategori të dënuarish që përjashtohen nga vuajtja e dënimit?
2. Në sqarimin tuaj thuhet se "për disa persona pavarësisht përfitimit të këtij ligji, e kanë vuajtur pjesën e dënimit të tyre". Sa është numri i tyre, dhe çfarë përfitojnë këta persona nëse e kanë vuajtur pjesën e dënimit të tyre? A është përfshirë kjo kategori tek të dhënat statistikore të përmenduar në sqarimin tuaj publik?
3. Mbështetur në të dhënat e Sektorit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Prokurorinë e Posaçme, nga ky ligj përfitojnë një numër personash të dënuar, si më poshtë vijon:


- a) Për vitin 2021 janë 16 persona. Për çfarë veprash penale kanë qenë të dënuar këta persona dhe sa prej tyre ishin duke vuajtur dënimin në burg?
- b) Për vitin 2022 janë 24 persona. Për çfarë veprash penale kanë qenë të dënuar këta persona dhe sa prej tyre ishin duke vuajtur dënimin në burg?
- c) Për vitin 2023 janë 18 persona. Për çfarë veprash penale kanë qenë të dënuar këta persona dhe sa prej tyre ishin duke vuajtur dënimin në burg?
- d) Për vitin 2024 janë 22 persona. Për çfarë veprash penale kanë qenë të dënuar këta persona dhe sa prej tyre ishin duke vuajtur dënimin në burg?

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të dërgimit të informacionit të kërkuar më sipër, brenda afatit të përcaktuar nga ligji.

Me respekt,

**GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE
KRYETARI**

Gazment BARDHI



[Shqiptar.com]



KUVENDI
NR. 1616/1 DATE 09.05.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. 6624/Prot
4

Tiranë, më 28.05.2024

Lënda : Kthim përgjigje

Drejtuar: Z. Gazment Bardhi

Kryetar i Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike

TIRANË

Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 25.04.2024, nëpërmjet së cilës kërkon sqarime mbi të dhënat e nxjerra nga Sektori i Ekzekutimit të Vendimeve Penale pranë Prokurorisë së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në lidhje me subjektet që përfitojnë nga ligji 33/2024 "Për dhënien e amnistisë", ju informojmë si më poshtë:

- Referuar nenit 4 "Kriteri ndalues për përfitim të amnistisë", të ligjit 33/2024 "Për Dhënie Amnistie, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, është përcaktuar se: "1. Pavarësisht nga parashikimet e shkronjave "a", "c" dhe "d", të nenit 3 të këtij ligji, nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit personat e denuar për: k) krime kundër autoritetit të shtetit", duke cilësuar nenet që nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit. Në mbështetje të këtij neni, është vërejtur se, neni 245/1 i K. Penal "Ushtrimi i ndikimit të pa ligjshëm ndaj personave që ushtrjnë funksione publike", veprë penale ndaj të cilës ushtron kompetencë Prokuroria e Posaçme, nuk është përfshirë në kategorinë e veprave që nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit, çfarë për rrjedhojë e bën atë veprë penale përfituese nga ky ligj.

Në vështrim të sa më sipër, personat e përmendur në statistikat e dhëna, janë persona të denuar për veprën penale "Ushtrimi i ndikimit të pa ligjshëm ndaj personave që ushtrjnë funksione publike" të parashikuar nga neni 245/1 të K. Penal, ku sipas ligjit 33/2024 "Për Dhënien e Amnistisë" përjashtohen nga vuajtja e dënimit.

2. Nga të dhënat e publikuara nga ana jonë sqarojmë se, personat e dënuar në vitin 2021 dhe vitin 2022, për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 i K. Penal "Ushtrimi i ndikimit të pa ligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", e kanë vuajtur dhe përfunduar dënimin e dhënë nga gjykata para hyrjes në fuqi të ligjit 33/2024 "Për Dhëni amnistie.
3. Për vitin 2023, janë 18 persona të dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 të K. Penal, nga të cilët 3 prej tyre kanë qenë të dënuar me burgim dhe për shkak se janë subjekte përfutuese të ligjit 33/2024 është bërë lirimi i tyre i menjëhershëm. Po kështu, edhe për 15 personat e të tjerë, të cilët nuk janë të dënuar me burgim nga gjykata, për këtë veprë penale, por janë dënuar me kusht dhe me punë në interes publik është aplikuar përjashtimi nga ky dënim.
4. Për vitin 2024, janë 22 persona të dënuar për veprën penale "Ushtrimi i ndikimit të pa ligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike" të parashikuar nga neni 245/1 të K. Penal nga të cilët, 1 prej tyre ka qenë i dënuar me burgim dhe duke qenë subjekt përfutues i ligjit 33/2024 është bërë lirimi i tij i menjëhershëm. Për 21 persona të tjerë të cilët nuk janë të dënuar me burgim nga gjykata, për këtë veprë penale, por janë dënuar me kusht dhe me punë në interes publik aplikohet përjashtimi nga ky dënim.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTUESI I PROKURORISË

ALTIN DUMANI

